



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.202/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti, Kryesues, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së materialit zgjedhor-posterit në mbi rrugë publike, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë;09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë;28.01.2025, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e Subjektit Politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.202/2025, e datës;26.01.2025 paraqitur kundër subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë; 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë;26.01.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën A.nr.202/2025, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, paraqitur kundër subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës, në të cilën pretendon se Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje në Skenderaj ka identifikuar baner/poster, të vendosur në hapësirë/rrugë publike, konkretisht në rrugën publike "18 Qershori", në Skenderaj të kandidatit për deputet nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës PDK, Mërgim Lushtaku, dhe më të njëjtin veprim kandidati dhe subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës, PDK, ka bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 2 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LZP, konkretisht neni 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i LZP-së parasheh: "1. *Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim:1.2 vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejell e pronarëve ose shfrytëzuesve*".

Më tutje parashtruesi i ankesës ka theksuar se subjekti përkatës, ka cenuar rëndë dispozitat përkatëse ligjore dhe duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, gjithashtu bazuar tashmë në praktikën e PZAP-së, mes tjerash me vendimet Anr.48/2025, Anr.49/2025, Anr.50/2025, Anr.51/2025, ka kërkuar që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi që dëshmojnë vendosjen e banerëve/posterëve në kundërshtim me LZP.

Më datë;27.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri më datë; 28.01.2025 në ora 15:00.

Në përgjigje në ankese subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, PDK, thekson se kërkon që PZAP ankesën e ankuesit t'a refuzojë si të pabazuar për arsye se lidhur me pretendimet e ankuesit, njofton PZAP se N.Sh "Foto Kabashi", me datë 21 janar 2025, ka marrë pëlqim nga Komuna e Skenderajt, që të bëjë vendosjen e pano reklamave në shtyllat e ndriçimit publik, si dhe vendosjes së shpalljeve dhe publikimeve të përkohshme në muret e objekteve private dhe objekteve tjera në afatin kohor një vjeçar e cila shkresë përmban numër të protokollit 09-334/01-0002929/25 dhe është nënshkruar dhe vulosur nga drejtori përkatës i kësaj drejtorie. Më tutje në përgjigje në ankesë kandidati për deputet Mërgim Lushtaku, më datë 21 janar 2025, ka lidhur kontratën Nr. protokollit 06/2025 për hapësira reklamuese me kompaninë N.Sh "Foto Kabashi" e cila në nenin 1, nën par.1.2 të saj është përcaktuar se qiramarrësi do të marrë në shfrytëzim hapësira reklamuese, nga data 21 janar 2025 e deri me datë 11 shkurt 2025, e cila dëshmon faktin se z. Mërgim Lushtaku ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për sigurimin e pëlqimit nga shfrytëzuesi i kësaj hapësire, para vendosjes së banerit/posterit. Si provë ka bashkangjitur Pëlqimin e Komunës së Skenderajt për Kompaninë N.Sh "Foto Kabashi" dhe Kontratën nr.prot.06/2025, si dhe ka kërkuar që të konstatohet se veprimet e ankimi nuk përbëjnë shkelje nga neni 34, par.1 nën par.1.2 të LZP-së.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës dhe vëren se ankesa është e bazuar.

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, sa i përket pretendimeve të parashtruesit se janë vendosur postera në hapësirë publike, konkretisht në hapësira të sponsorizuara pranë parkut të qytetit përball Gjykatës Themelore në Skenderaj në Rrugën "18 Qershori" të kandidatit për deputet Mërgim Lushtaku, nga radhët e subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për Panelin këto pretendime janë të pa bazuara dhe nuk mund të merret se kandidati i subjektit politik PDK ka shkelur nenin 34, pika 1 nën paragrafi 1.2 të LZP-në. Kjo për faktin se nga prova e bashkuar në përgjigjen në ankese rezulton se Drejtoria për Shërbime Publike në Skenderaj, në baze të kërkesës numër 01-110-0002929/25, të datës;21.01.2025 nga kompania Foto Kabashi me seli në Skenderaj, ka nxjerr pëlqim duke lejuar kompanisë Foto Kabashi" NSH, të bëjë vendosjen e panove reklamuese në shtyllat e ndriçimit publik dhe vendosjen e shpalljeve dhe publikimeve të përkohshme në muret e objekteve private dhe objekteve tjera në afatin kohor 1 vjeçar. Duke u bazuar në ligjet dhe rregulloret e Komunës Skenderaj Drejtoria për Shërbime Publike ka dhënë Pëlqimin në fjale për 1 vit nga data e protokolluar.

Kandidati për deputet Mërgim Lushtaku duke pasur parasysh pëlqimin e lartcekur ka lidhur kontrate me NSH ‘Foto Kabashi’ me datë;21.01.2025, për hapësira reklamuese te cilat gjendet ne rrugën “18 Qershori” në Skenderaj deri me datë;11.02.2025, për çmimin kontraktues për hapësira reklamuese ne shumen prej 300 eurove.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkuara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtresuesi i ankesave nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lart.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A.nr.202/2025, datë;28.01.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas neni 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.